

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00 Nr.Br.100/2022	Data: Datum: 29.06.2022	

Kuvendi i Komunës së Istogut në bazë të nenit 40.2 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008) si dhe nenin 16 paragrafi 8 pika 8.1 dhe 8.2 i Ligjit Nr. 08/L-066 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, dhe nenit 33.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01Nr.62/10, në mbledhjen e mbajtur më: 29.06.2022, shqyrtoi dhe miratoi propozimin e Kryetarit të Komunës për listën e projekte të reja kapitale në bashkëfinancim me komunitetin për vitin fiskal 2022, dhe merre këtë:

V E N D I M

PËR PROJEKTIN E RI KAPITAL NË BASHKËFINANCIM ME KOMUNITETIN "NDËRTIMI I RRUGËVE NË FSHATRA E KOMUNËS SË ISTOGUT-ISTOG TË POSHTËM LAGJA "LLAPAJ", "ZEKAJ, NIMANAJ, ZEQRIRAJ DHE IDRIZAJ", NË LAGJEN "SADRI SUTAJ" NË CARALLUKË, NË LAGJEN "GASHAJ" NË PRIGODË, NË LAGJEN "HAJZERAJ" NË ORROBERDË, "QAFË MALI" NË SUHOGERLLË, NË "DRAGOLEVC, , NË LAGJEN "SALIHAI" NË SHUSHICË TË ULËT, NË LAGJËN "BLAKAJ" NË TRUBUHOC, NË LAGJET "GORQAJ DHE ZEQRIRAJ" NË STUDENICË." PËR VITIN FISKAL 2022

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për projektin e ri kapital në bashkëfinancim me komunitetin për vitin fiskal 2022.
2. Duke u bazuar në ligjin mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, projektet të cila komuna i ka me bashkëfinancim, me rastin e participimit të komitetit ose donatorëve tjerë në nivelin lokal me qeraste krijohet kod i ri të projekteve kapitale në tabelën 4.2, bazuar në projektin për bashkëfinancim "Projekti me participim te Komunitetetit ,ministrive te linjës,Donatoret e jashtëm " me kod 50240.
3. Projekti "Ndërtimi I rrugëve në fshatrat e komunës së Istogut, Istog të Poshtëm lagja "Llapaj","Zekaj, Nimanaj, Zeqiraj dhe Idrizaj", në lagjen "Sadri Sutaj" në Carallukë, në lagjen "Gashaj" në Prigodë, në lagjen "Hajzeraj" në Orroberdë, "Qafë Mali" në Suhogerllë, në "Dragolevc, , në lagjen "Salihaj" në shushicë të Ulët, në lagjën "Blakaj" në Trubuhoc, në lagjet "Gorqaj dhe Zeqiraj" në Studenicë.
4. Nga të cilat komuna e Istogut bashkë-financon në shumën financiare prej : 116,408.50 euro, ndërsa komuniteti bashkë-financon në shumën prej : 37,995.00 euro, totali i projektit në fjalë është gjithsej: 154,403.50 euro


 REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT
 REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
 DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
 UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE

Udies Izlázna

Nr. 54-039
Br:

Data 05.07.2022
Datum

ISTOG-ISTOK

5. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyrtari Kryesor Financiar që më planin e Rishikimit të buxhetit komunal të njoftojë Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave për procedim të mëtejshëm në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi.
6. Ky Vendim hynë në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit të tij në faqen zyrtare të Komunës. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesën: Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.
7. Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Departamenti i Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, Departamenti i Përgjithshëm i Thesarit në Prishtinë, Kryetari i Komunës, Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) dhe një kopje në arkivin e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit,
z. Enver Rugova

